



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 315/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesa e Agim Aliut nga koalicionit PDK-AAK-NISMA, paraqitur kundër komisionerëve të vendvotimit 2501Y/06R, për shkak të parregullsive në numërimin e votave, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare në seancën e panelit të mbajtur me 15.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa A.nr 315/2017 e datës 12.06.2017, e parashtruar nga Agim Aliu kandidat për deputet nga koalicionit PDK-AAK-NISMA.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 12.06.2014, ka pranuar ankesën Anr. 315/2017 nga Agim Aliut kandidat për deputet nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, në të cilën pretendohet se me datën 11.06.2017 në vendvotimin 2501Y/06R e tërë lista është me zero vota për të gjithë kandidatët. Parashtruesi i ankesave kërkon që të bëhet rinumërimi i kësa kutive të votimit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultati preliminar nuk është shpallur nga KQZ-ja dhe se mund të ndryshoj në çdo moment, po ashtu Qendra e Numërimit dhe Rezultateve QNR ende është në fazën e procedimit të materialeve zgjedhore nga Qendrat e Votimit. Andaj rezultati zgjedhor nuk ka marrë formën përfundimtare, në momentin e shpalljes së rezultateve përfundimtare të QNR-së palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme mund të ushtroj ankesën në afatin prej 24 orëve.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të Nenit 118.1 të LQP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin

standardet” dhe Nenit 6.4 te Rregullave dhe Procedurave te PZAP-it, ne të cilin përcaktohet se: “Ankesat të cilat janë të palejuar dhe te pasafatshme PZAP-i i hudhë poshtë me vendim”, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A nr. 315/2017 më datën 15.06.2017

Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Rafet Haxhaj', is written over a circular official stamp. The stamp contains text in Albanian, including 'Këshillë Juridike' and 'Këshillë Juridike e PZAP-it', and features a central emblem with the number '12'.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.